REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 118 AKTI **NR. 142 VENDIMI**

Tiranë, më 19.4.2019

VENDIM

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Etleda Çiftja	Anëtare
Genta Tafa (Bungo)	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, më datë 18.4.2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (Ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Dhorina Theodhori**, prokurore/drejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar" (referuar më poshtë "Kushtetuta");

Ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" (referuar më poshtë "ligji nr. 84/2016");

Ligji nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë";

Ligji nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), mori në shqyrtim dhe analizoi shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen, duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit: atë pasuror, të figurës dhe vlerësimin profesional, mbështetur në pikat 1 dhe 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Subjekti i rivlerësimit, znj. **Dhorina A. Theodhori**, ushtron detyrën e prokurorit/drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, detyrë të cilën e ka filluar në muajin nëntor të vitit 2007 dhe, në bazë të pikës 4 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

Ajo i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt me shortin e hedhur më datë 15.3.2018 në përputhje me rregulloren "Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit".

Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 26.3.2018, u caktua me mirëkuptim si kryesues, znj. Pamela Qirko, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga asnjë prej anëtarëve të trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin Dhorina Theodhori.

Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Prokuroria e Përgjithshme, si organ i vlerësimit të aftësive profesionale. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

Inspektoriati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) ka kryer procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 19.1.2018, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar se:

1) *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin;*
2) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
3) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
4) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
5) *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit 84/2016, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. ***, datë 11.4.2018, për subjektin

e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të të cilit ka konstatuar *përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Dhorina Theodhori.*

Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr. *** prot., datë 24.4.2018.

Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm.

Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, më datë 10.4.2019 vendosi përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit, si dhe njoftimin e këtij subjekti për t'u njohur me materialet e dosjes, dokumentet e administruara nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative.

Subjekti i rivlerësimit u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkojë marrjen e provave të reja, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga ana e Komisionit më datë 10.4.2019. Subjekti i rivlerësimit ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja më datë 16.4.2019.
Pas shqyrtimit të këtyre shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht, më datë 16.4.2019.
Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 18.4.2019, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra.
Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, duke shprehur opinionin e saj në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer.
Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Dhorina Theodhori ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit ndaj saj, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ. Ajo ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur. Subjekti i rivlerësimit ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

A. VLERËSIMI I PASURISË

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, "Vetting";
b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
d) deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit;
f) deklarimet e personave të tjerë të lidhur.

Në deklaratën e pasurisë "Vetting", të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, subjekti deklaron këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

1. Pasuria me nr. ***, zona kadastrale ***, me sipërfaqe 56 m². Pjesa takuese 1/3 ose 33%, në bashkëpronësi me Zh. dhe E. Th.
Burimi i krijimit sipas deklaratës "Vetting": Fituar me trashëgimi ligjore sipas vendimit nr. ***, datë 10.4.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Subjekti ka dorëzuar këto dokumente:

- Certifikatë pronësie, nr. ***, datë 16.3.2011, e dyqanit me sipërfaqe 56 m²;
- Kartelë pasurie e apartamentit me sipërfaqe 67 m²;
- Vendim gjyqësor nr. ***, datë 10.4.2006, me objekt: "Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë" të trashëgimlënësit A. Th.

Hetimi i Kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë, nr. *** prot., datë 3.4.2018, drejtuar ZVRPP-së Korçë;

  Kthim përgjigje ZVRPP-ja Korçë, nr. ***prot., datë 10.4.2018
- Shkresë, nr. *** prot., datë 3.4.2018, drejtuar OSHEE-së;

  Kthim përgjigje OSHEE-ja, nr. *** prot., datë 17.4.2018
- Shkresë, nr. *** prot., datë 3.4.2018, drejtuar UKT-së;

  Kthim përgjigje UKT, nr. *** prot., datë 20.4.2018
- Shkresë, nr. *** prot., datë 26.11.2018, drejtuar Bashkisë Korçë;

  Kthim përgjigje Bashkia Korçë, nr. *** prot., datë 5.12.2018
- Shkresë, nr. *** prot., datë 1.11.2018, drejtuar shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime" Korçë;

Kthim përgjigje UKKO-ja, nr. ***prot., datë 6.11.2018

- Shkresë, nr. *** prot., datë 1.11.2018, drejtuar OSHEE-së Korçë;

Kthim përgjigje OSHEE-ja Korçë, nr. *** prot., datë 13.11.2018

Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se burimi i kësaj pasurie në bashkëpronësi, është trashëgimia nga babai i saj, z. A. Th. Më datë 10.4.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. *** ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore të trashëgimlënësit A.Th., duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të tij: *"Bashkëshorten Zh.Th. dhe dy fëmijët e tij: Dhorina Theodhori dhe E. Th., të cilat kanë përfituar 1/3 pjesë të pasurisë trashëgimore."*

Bazuar në shkresën e ZVRPP-së Korçë rezulton se, subjekti i rivlerësimit ka në bashkëpronësi pasurinë me nr. ***, zona kadastrale ***, pasuri e llojit truall, me sipërfaqe 56 m², nga kjo, ndërtesë me sipërfaqe 55 m²; disponon 1/3 e pasurisë.
Nga dokumentacioni i administruar rezulton se kjo pasuri ka qenë në bashkëpronësi të z. A. A. dhe babait të subjektit të rivlerësimit, z. A. Th. Më datë 24.6.1998, me kontratë nr. ***, babai i subjektit ka blerë pjesën tjetër të kësaj pasurie për shumën 400, 000 lekë.

Në lidhje me këtë pasuri, në deklaratën e interesave private të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *"Ndryshimi i strukturës, rikonstruksioni i çatisë, fasadave dhe shtesë kati në dyqanin te Tregu i Qytetit të Korçës, në kuadër të investimeve të kryera nga Bashkia e Qytetit Korçë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit (ende në proces regjistrimi pasi nuk ka përfunduar procesi i marrjes në dorëzim nga Bashkia Korçë)."*

Për të vërtetuar deklarimin e subjektit të rivlerësimit, Komisioni i kërkoi informacion Bashkisë Korçë. Bashkia sqaron se nga ana e saj është investuar në restaurimin e Pazarit të Vjetër të Korçës, me një projekt madhor për rivitalizimin e zonës së mbrojtur të monumenteve të kulturës. Kjo ndërhyrje ka qenë në trajtë blloqesh për vetë natyrën dhe ekzistencën e objekteve ekzistuese dhe jo për objekte të veçanta. Subjektet (pronarët e dyqaneve) nuk kanë pasur kontribut në këtë investim. Investimi ka përfunduar dhe është në periudhën e garancisë së punimeve, deri më datë 9.10.2019.
Bashkia ka vënë në dispozicion dokumentacionin përkatës, nga ku rezulton se objekti në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të saj është pjesë e bllokut ***. Objekti ka qenë njëkatësh dhe sipas projektit i është bërë një shtesë kati. Vlera e shtesës sipas preventivit ka qenë 1, 356,852 lekë.
Komisioni i kërkoi informacion më të zgjeruar subjektit të rivlerësimit në lidhje me këtë pasuri. Në përgjigjen e saj, ajo sqaron se: *"Dyqanin, të cilin e kam në bashkëpronësi së bashku me mamin dhe motrën, për shkak të trashëgimisë ligjore, nuk e kemi lëshuar më parë me qira. Më parë dyqani, për shkak të punimeve që janë kryer në zonën e Pazarit të Korçës, të cilat kanë zgjatur disa vite, por edhe për shkak të mungesës së punimeve të kryera në ambientin e brendshëm ka qënë jofunksional. Gjatë këtyre viteve, dyqani ka patur probleme me hidroizolimin dhe mirëmbajtja e këtij objekti është fokusuar vetëm në kryerjen e shpenzimeve minimale për largimin e lagështirës. Këtë fakt e provoj me shpenzimet prej 0 – 51 (maksimumi) energji të shpenzuar për këtë objekt, si dhe me faktin që vetëm në datën 19.7.2018 unë kam lidhur kontratën me "Ujësjellës Kanalizime" Korçë. Aktualisht dyqanin e kemi lëshuar me qira në datën 8.10.2018, shtetases K. A., sipas kontratës me nr. *** rep., *** kol., dhe subjektit "***" sh.p.k, sipas kontratës *** rep.,*

**** kol., datë 8.10.2018. Bashkëlidhur po ju vëmë në dispozicion kopje të kontratës dhe të dokumentacionit që saktëson pagimin në burim të tatimit për secilën kontratë qiraje."*

Nga ana e subjektit të rivlerësimit është vënë në dispozicion:

- Kontratë qiraje, nr. ***, datë 8.10.2018;
- Kontratë qiraje, nr. ***, datë 8.10.2018;
- Faturë tatimore, nr. ***, datë 31.1.2018;
- Pagesë tatimi në burim, Credins Bank;
- Ekstrakti i regjistrit tregtar i shoqërisë "***" sh.p.k.;
- Kontrata për shërbime "Ujësjellës Kanalizime", datë 19.7.2018, lidhur nga subjekti i rivlerësimit.

Bazuar në deklarimet e subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionin e mësipërm, rezulton se kati i dytë i dyqanit i është dhënë me qira znj. K. A. për dy vjet, me kontratë qiraje nr. ***, datë 8.10.2018, për shumën 35, 000 lekë, ndërsa kati i parë i është dhënë shoqërisë "***" sh.p.k. për dy vjet, me kontratë qiraje nr. ***, datë 8.10.2018 për shumën 46,000 lekë.
Nga ana e UKKO-së informohemi se në emër të subjektit të rivlerësimit është hapur një kontratë furnizimi me ujë të pijshëm për këtë pasuri.
Nga ana e OSHEE-së nuk konfirmohet që subjekti i rivlerësimit të ketë kontratë furnizimi me energjinë elektrike për këtë dyqan. Në lidhje me këtë konstatim i është kërkuar informacion subjektit të rivlerësimit.
Në shpjegimet e saj ajo sqaron se: *"Bashkëlidhur pyetësorit po ju vë në dispozicion kontratat dhe vërtetimet e kërkuara nga ana Juaj. Referuar vërtetimit me nr. *** prot, datë 14.2.2019 rezulton se për pasurinë dyqan është lidhur kontrata e energjisë elektrike me nr. ***, në emër të A. Th., ndërkohë që kontrata me "Ujësjellës Kanalizime" është lidhur nga ana ime (pasi më parë nuk ka patur kontratë për furnizimin me ujë), në datën 19.7.2018 dhe kontrata mban nr. ***; ***."*

Subjekti bashkëlidhur ka vënë në dispozicion:

- Vërtetim, nr. *** prot., datë 14.2.2019 të OSHEE-së.

Duke qenë se ndryshimi i strukturës së kësaj pasurie është deklaruar nga subjekti vetëm në deklarimin e pasurisë për vitin 2017, rezultoi e paqartë se kur kanë filluar punimet për këtë rikonstruksion dhe kur i ka lindur detyrimi subjektit për ta deklaruar.

Për këtë është pyetur subjekti, e cila, më datë 8.4.2019, shpjegoi se: "*Pas administrimit të shkresës me nr. *** prot., datë 5.4.2019 të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Korçë, punimet e kryera në dyqanin e ndodhur në Pazarin e vjetër të qytetit të Korçës, të cilin e kam në bashkëpronësi me nënën dhe motrën time, kanë filluar mbas datës 16.3.2017 dhe kanë përfunduar në datën 15.9.2017.*"
Në mbështetje të këtij deklarimi, subjekti ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 5.4.2019 të Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë, vendimin nr. ***, datë 8.3.2017, të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve pranë Ministrisë së Kulturës, si dhe certifikatën e marrjes në dorëzim nga Bashkia Korçë të objektit (restaurim i objekteve të pazarit Korçë), datë 9.10.2017.

Komisioni vlerëson se subjekti ka qenë i saktë në deklarim. Të dhënat e referuara prej saj, konfirmohen edhe nga dokumentacioni shkresor i institucioneve përkatëse. Në lidhje me këtë pasuri nuk lindin dyshime apo paqartësi.

2. Pasuria me nr. ***, zona kadastrale ***, me sipërfaqe 67 m². Pjesa takuese 1/6 ose 16.6 %, në bashkëpronësi me Zh. dhe E.Th.

Burimi i krijimit sipas deklaratës "Vetting": fituar me trashëgimi ligjore, sipas vendimit nr. ***, datë 10.4.2006, të Gjykatës së Rrethit Korçë.
Subjekti ka depozituar dokumentat e përmendura për pasurinë e mësipërme.
Hetimi i Komisionit për këtë pasuri u krye së bashku me pasurinë e përshkruar më sipër.

Arsyetimi ligjor

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar rezulton se kjo pasuri është blerë nga babai, nëna dhe gjyshja e subjektit të rivlerësimit (duke përfituar secili 1/3 pjesë takuese), me kontratë privatizimi banese, datë 28.7.1993, për shumën 7120 lekë. Më datë 8.12.1994, nëpërmjet aktit mbi heqjen dorë nga pronësia nr. ***, gjyshja e subjektit të rivlerësimit ka hequr dorë nga pjesa e saj takuese në këtë apartament në dobi të babait të subjektit të rivlerësimit. Më pas, në vitin 2006, kjo pasuri ka kaluar nëpërmjet trashëgimisë ligjore, në bashkëpronësi të subjektit si dhe nënës e motrës së saj.

Nga ana e OSHEE-së nuk konfirmohet që subjekti i rivlerësimit të ketë kontratë furnizimi për energji elektrike për këtë apartament. Në lidhje me këtë konstatim i është kërkuar informacion subjektit të rivlerësimit.
Në shpjegimet e saj ajo sqaron se: *"Bashkëlidhur pyetësorit po ju vë në dispozicion kontratat dhe vërtetimet e kërkuara nga ana Juaj. Referuar vërtetimit me nr. *** prot, datë 14.2.2019, rezulton se për banesën është lidhur kontrata me OSHEE-në me nr. *** në emër të Dh. Th. (emri i gjyshes me lapsus), ndërkohë që kontrata me "Ujësjellës Kanalizime" është lidhur po në emër të gjyshes time, Dh. Th. dhe mban nr. ***."*

Subjekti bashkëlidhur ka vënë në dispozicion:

- Vërtetim, nr. *** prot., datë 14.2.2019 të OSHEE-së;
- Kontrata për shërbime "Ujësjellës Kanalizime", lidhur nga Dh. Th.;

Komisioni vlerëson se subjekti ka qenë i saktë në deklarim. Nga hetimi administrativ nuk rezultojnë të dhëna të paqarta apo dyshime në lidhje me këtë pasuri.

3. Për pasurinë apartament, më lart, subjekti ka deklaruar në deklaratën "Vetting": **shtesë prej 12 m², në banesë** (në proces legalizimi). Pjesa takuese 33%.
Burimi i krijimit sipas deklaratës "Vetting": Të ardhura prej kursimeve familjare të shtetasit A. Th.

Subjekti ka dorëzuar këto dokumente:

- *Shkresë nr. ***, datë 24.1.2017 nga ALUIZNI Korçë, ku vërtetohet se subjekti është aplikues për proces legalizimi.*

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë, nr. *** prot., datë 3.4.2018, drejtuar ALUIZNI-t;
  Kthim përgjigje ALUIZNI, nr. *** prot., datë 17.4.2018;

➢ Shkresë, nr. *** prot., datë 12.2.2019, drejtuar Drejtorisë së ALUZINI-t Korçë; Kthim përgjigje Drejtoria e ALUZINI-t Korçë, nr. *** prot., datë 14.2.2019

Arsyetimi ligjor

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka aplikuar pranë ALUZINI-t me kërkesë nr. ***, datë 18.8.2014, për legalizimin e një ndërtimi informal të llojit shtese anësore, me sipërfaqe 12.5 m² në objekt ekzistues, godinë kolektive, me adresë: rruga "***", lagjja ***, Korçë.
Në këtë aplikim rezulton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si vit ndërtimi, vitin 2009.

Në lidhje me këtë konstatim është pyetur subjekti i rivlerësimit e cila sqaron se: *"Dua të saktësoj faktin se në shtëpinë ku unë banoj kam 1/6 pjesë në bashkëpronësi me mamin dhe motrën time. Ndërtimi për kryerjen e një shtesë (aneksi) prej 12 m ², ka filluar që në kohën kur jetonte babai im (në formën e forcimit të kolonave të betonit), ndërkohë që punimet janë ndërprerë pas vdekjes së tij dhe kanë vijuar më pas nga nëna ime. Në kohën e raportimit të këtij ndërtimi, të cilin duhet ta plotësonte nëna ime, pasi ajo kishte njohuritë e duhura për kohën e saktë të kryerjes së tij punimi, ajo pati një problem shëndetësor që lidhej me pamundësinë për të ecur e për këtë shkak kam shkuar unë për të bërë deklarimin përkatës.*

Vijoj t'i qëndroj deklarimit tim, se burimi i të ardhurave për ndërtimin kanë qënë kursimet familjare, pasi gjatë procesit të ndërtimit, unë kam qenë studente në Shkollën e Magjistraturës, me të ardhura gjysmën e pagës së prokurorit, ndërkohë që motra vijonte studimet dhe nuk kishim të ardhura për të kryer këtë ndërtim, vlera e të cilit duhet të jetë rreth 200.000 (dyqind mijë) lekë Dua të theksoj faktin se viti 2009, i raportuar në deklaratën e vetëdeklarimit, lidhet me çastin kur objekti është bërë funksional dhe i banueshëm nga ana jonë. Kjo ka qënë edhe arsyeja pse nga ana ime janë raportuar si burim i krijimit të kësaj pasurie kursimet që i përkasin babait tim, pasi kanë qenë të ardhura të destinuara familjarisht për këtë ndërtim, që në kohën kur ai ka qënë gjallë."

Nga shqyrtimi i deklaratave periodike të interesave të këtij subjekti, Komisioni ka konstatuar se kjo shtesë është deklaruar për herë të parë në vitin 2014, që përkon me vitin e aplikimit pranë ALUIZNI-t. Në këto kushte, duke qenë detyrim ligjor deklarimi edhe i të drejtave reale mbi pasuritë e paluajtshme, subjektit iu kalua barra e provës për të shpjeguar bindshëm arsyet e këtij mosdeklarimi që nga viti 2009, që rezulton si vit ndërtimi, sipas vetëdeklarimit, deri në vitin 2014.

Pas kalimit të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit, znj. Theodhori, sqaroi se për shtesën e shtëpisë prej 12 m², prej së cilës vetëm 2 m² i takojnë vetë subjektit, ka vlerësuar se data e aplikimit pranë ALUIZNI-t është edhe data e paraqitjes së kërkesës ligjore për fitimin e të drejtave të pronësisë që njeh ligji mbi këtë pasuri. Subjekti pretendon se deri në atë moment, ka vlerësuar se kjo pasuri ishte jashtë qarkullimit ligjor civil dhe nuk mund të ushtroheshin të plota tagrat e pronësisë.
Në përgjigjen e saj, subjekti ka theksuar se: *"Ndonëse duke qenë ende në proces vlerësimi, kjo pasuri nuk përbën ende një pasuri mbi të cilin të kemi të drejtat që i njeh ligji pronarit, por kam vlerësuar se deklarimi duhet të bëhej në vitin 2014, vit në të cilin kam saktësuar edhe kohën e saktë të kryerjes së ndërtimit. Pra, në asnjë moment nuk kam patur për qëllim fshehjen apo mosdeklarimin e saktë të kësaj pasurie (ku unë kam 2 metra katrorë) si edhe as motiv për mosdeklarimin e saj."*

Për këtë shtesë prej 12 m², subjekti i rivlerësimit paraqiti dokumentacion ligjor provues, nga i cili rezultoi se ajo nuk ka pasur kontribut personal në ndërtimin e saj dhe nga hetimi u provua se shtesa ka përfunduar në kohën kur znj. Theodhori sapo kishte përfunduar studimet në Shkollën e Magjistraturës dhe ishte emëruar në detyrën e prokurorit.

Komisioni, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura me shkrim të subjektit, si dhe e dëgjoi atë në seancë dëgjimore, konstaton se subjekti ka qenë i saktë në plotësimin e deklaratës "Vetting" si deklaratë e re dhe e detajuar e pasurisë, detyrim ky, kushtetues. Megjithëse deklarimet ndër vite të subjekteve pranë ILDKPKI-së, bazuar në nenin 32 të ligjit nr. 84/2016, mund të përdoren si provë, Komisioni vlerëson se ky mosdeklarim gjatë viteve 2009-2013, nuk mund të konsiderohet si fshehje për efekt të ligjit nr. 84/2016, për shkak se nuk rezultoi e provuar gjatë hetimit se shkaku i mosdeklarimit ka pasur për qëllim fshehjen e të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e kësaj pasurie, përderisa subjekti i rivlerësimit nuk ka kontribuar financiarisht për të.

Komisioni konkludon se subjekti ka deklaruar me saktësi në deklaratën "Vetting" të dhënat mbi këtë pasuri të paluajtshme. Nga hetimi administrativ nuk rezultojnë të dhëna të paqarta apo dyshime në lidhje me këtë pasuri.

4. Pasuria nr. *** të radhorëve të pronësisë, pyll dhe kullotë, me sipërfaqe të përgjithshme 252 ha pyll dhe 150 ha kullotë. Pjesa takuese 16/1920 ose 0.5 %, në bashkëpronësi me Zh. dhe E. Th., etj.

Burimi i krijimit sipas deklaratës "Vetting": fituar me vendimin e Agjencisë së Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave.

Subjekti ka dorëzuar këto dokumente:

- Vërtetim hipotekor, nr. ***, datë 23.10.2012; bashkëlidhur lista e bashkëpronarëve, ndër ta edhe Zh., Dhorina dhe E. Th.;
- Kontratë shitblerje, nr. ***, datë 31.10.2013;
- Kontratë shitblerje, nr. ***, datë 21.11.2012; nëpërmjet kësaj kontrate, shtetasit S., N. dhe Q. B. i kanë shitur z. F. K. një sipërfaqe, arë 200 m², ndodhur në fshatin *** të Korçës;
- Kontratë shkëmbimi, nr. ***, datë 4.12.2012;
- Kartelë e pasurisë së paluajtshme, nr. ***, zona kadastrale ***, me sipërfaqe 32434 m², e llojit kullotë.

Hetimi i Kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë, nr. *** prot., datë 3.4.2018, drejtuar ZVRPP-së Korçë; Kthim përgjigje ZVRPP-ja Korçë, nr. *** prot., datë 10.4.2018

Arsyetimi ligjor

Komisioni hetoi në lidhje me vërtetësinë e këtij deklarimi të subjektit. Bazuar në shkresën e ZVRPP-së Korçë, të administruar nga ana e ILDKPKI-së, rezulton se me vendimin nr. 780, datë 16.1.2009 të Zyrës Rajonale të Kthimit e Kompensimit të Pronave Korçë, është njohur e drejta e pronësisë për pronën pyll dhe kullotë, me sipërfaqe të përgjithshme 252.6 ha, nga të cilat 102.6 ha pyll dhe 150 ha kullotë, të ndodhur në fshatin ***, Komuna ***, Korçë, subjekteve të shpronësuar, të cilët janë familjarët e subjektit të rivlerësimit, si dhe vetë subjekti i rivlerësimit, duke vendosur

dhe kthimin e pronës. Bazuar në vërtetimin nga dokumenti hipotekor i datës 23.10.2012, të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se ajo disponon 16/1920 pjesë.

Më datë 4.12.2012, me kontratë shkëmbimi nr. ***, subjekti i rivlerësimit së bashku me nënën dhe motrën e saj dhe disa familjarë të tjerë, një pjesë të kësaj pasurie e kanë shkëmbyer me 200 m² arë në ***, me numër pasurie ***, zona kadastrale ***, të cilën, më datë 31.10.2013, me kontratë shitblerje nr. ***, e kanë shitur për shumën 50,000 lekë.
Komisioni vlerëson se subjekti ka qenë i saktë në deklarim. Nga hetimi administrativ nuk rezultojnë të dhëna të paqarta apo dyshime në lidhje me këtë pasuri.

5. Në lidhje me **automjet, me targa** ***, i markës "Volkswagen", vit prodhimi 1998, përfituar me kontratën nr. ***, datë 24.11.2011, vlera 1000 euro.
Burimi i krijimit sipas deklaratës "Vetting": kursimet personale.

Subjekti ka dorëzuar këto dokumente:

- Kontratë shitblerje, nr. ***, datë 24.11.2011, me vlerë 1000 euro.

Hetimi i Kryer nga ana e Komisionit:

- Shkresë, nr. *** prot., datë 3.4.2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Shërbimeve të Transportit Rrugor Korçë dhe Tiranë;

Kthim përgjigje DRSHTRR-ja Korçë, nr. *** prot., datë 6.4.2018
Kthim përgjigje DRSHTRR-ja Tiranë, nr. *** prot., datë 12.4.2018

Arsyetimi ligjor

Në lidhje me këtë pasuri të luajtshme, të deklaruar nga subjekti, Komisioni, pas hetimit të kryer, verifikoi vërtetësinë e deklarimit të subjektit, si dhe mundësitë e tij financiare për përballimin e këtij shpenzimi. Bazuar në shkresën e DRSHTRR-së Korçë, rezulton se subjekti i rivlerësimit është pronar i një mjeti me targa ***. Ky automjet është blerë nga subjekti i rivlerësimit më datë 24.11.2011 me kontratë nr. *** për shumën 1.000 euro. Nga analiza financiare e kryer ndër vite, rezulton se subjekti ka patur aftësi financiare për të kryer një shpenzim të tillë.
Komisioni vlerëson se subjekti ka qenë i saktë në deklarim. Nga hetimi administrativ nuk rezultojnë të dhëna të paqarta apo dyshime në lidhje me këtë pasuri.

6. Në lidhje me **likuiditetet dhe depozitën me afat tek Raiffeisen Bank,** me titullar depozite Zh. Th. dhe person të autorizuar Dh. Th., me balancë 407.012 lekë.
Burimi i krijimit sipas deklaratës "Vetting": kursime familjare.

Hetimi i Kryer nga ana e Komisionit:

- **Shkresë, nr. *** prot., datë 3.4.2018, drejtuar bankave;**
  Kthim përgjigje Raiffeisen Bank, nr. *** prot., datë 10.4.2018
  Kthim përgjigje Credins Bank, nr. *** prot., datë 1.8.2018

- **Shkresë, drejtuar Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, nr. *** prot., datë 3.4.2018;**
  Kthim përgjigje QKR-ja nr. *** prot., datë 19.4.2018

- **Shkresë, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nr. *** prot., datë 3.4.2018;**
  Kthim përgjigje DPT-ja me nr. *** prot., datë 12.4.2018

- **Shkresë DPT-ja me nr. *** prot., datë 12.4.2018, drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe për dijeni Komisionit;**
  Kthim përgjigje DRT-ja Tiranë nr. *** prot., datë 24.4.2018

- **Shkresë, nr. *** prot., datë 2.11.2018, drejtuar shoqërisë "***" sh.p.k.**
  Kthim përgjigje "***" sh.p.k., datë 7.12.2018

Arsyetimi ligjor

Bazuar në shkresën e Raiffeisen Bank rezulton se:

- Më datë 15.8.2008, subjekti i rivlerësimit ka marrë kredi në shumën 1,000,000 lekë me afat 84 muaj. Qëllimi i dhënies së kredisë bazuar në kontratën e kredisë ka qenë për arsye personale.
- Më datë 28.9.2012 subjekti i rivlerësimit ka marrë kredi në shumën 436,800 lekë me afat 36 muaj. Qëllimi i dhënies së kredisë bazuar në kontratën e kredisë ka qenë për arsye personale.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit bankar të administruar, Komisioni konstatoi se disa shtetas kanë depozituar lekë në këtë llogari me qëllim pagimin e kësteve të kredisë.
Është pyetur subjekti i rivlerësimit në lidhje me këta shtetas. Në përgjigjen e saj ajo ka sqaruar se ata e kanë ndihmuar vetëm për kryerjen e veprimit fizik të pagesës së kësteve të kredisë, për shkak të pamundësisë së saj, si pasojë e angazhimeve në punë. Njëri prej këtyre shtetasve është daja i subjektit, shtetasi N. A.

Ndërkohë, Komisioni, pas përgjigjeve të subjektit ka konstatuar se dy prej këtyre shtetasve janë punonjës të Prokurorisë së Rrethit Korçë. Në këto kushte, Komisionit ka konstatuar se subjekti ka përdorur burimet njerëzore të institucionit, shtetasit A.K. dhe K. L., për qëllime personale, që nuk kanë lidhje me detyrat funksionale të tyre, veprim i cili duket se nuk përputhet me etikën e prokurorit, duke i kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime në lidhje me këtë konstatim.

Në përgjigje të këtij rezultati hetimi, subjekti ka arsyetuar se, për shkak të mbingarkesës së saj në punë, shtetasit A. K. dhe K. L., nisur nga marrëdhëniet e mira shoqërore midis tyre, e kanë ndihmuar duke kryer veprimin bankar për pagimin e kësteve të kredisë në emër të saj.

Ajo gjithashtu ka theksuar se ata nuk janë shkëputur nga puna posaçërisht për të bërë këto pagesa për llogari të saj, por përgjatë kryerjes së detyrave të tyre funksionale në institucionet bashkëpunuese të Prokurorisë, që gjenden në afërsi me këto banka, kanë mundur të kryejnë edhe këto veprime bankare për të. Për të mbështetur këto deklarime, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur dokumentacion provues në lidhje me detyrat e këtyre punonjësve pranë institucioneve ligjzbatuese që gjenden në afërsi të këtyre bankave.

Komisioni konstaton se në kohën e depozitimit të shumave për pagesat e kështit të kredive, subjekti nuk ka qenë drejtuese e prokurorisë, fakt i cili theksohet edhe nga ana e saj. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ka patur marrëdhënie varësie me këta punonjës në momentin e kryerjes së depozitimit të shumave për pagesat e kështit të kredive të saj, kjo duhet konsideruar si rrethanë lehtësuese që mund të merret parasysh për të vërtetuar deklarimet e subjektit se këto veprime janë diktuar nga marrëdhëniet e mirëbesimit dhe respektit.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se, pavarësisht marrëdhënieve shoqërore ndërmjet subjektit dhe këtyre dy shtetasve, apo ngarkesës në punë të saj, ky veprim nuk është profesional, por nuk mund të konsiderohet i tillë që të shërbejë shkak për ta konsideruar si cenim të etikës së figurës së prokurorit.

Gjatë hetimit administrativ, Komisioni, gjithashtu ka hetuar në lidhje me llogarinë në euro të hapur nga subjekti pranë Bankës Raiffeisen më datë 9.5.2008.
Duke qenë se u konstatuan dy transferta bankare në drejtim të shtetasit P. M. në vitet 2008 dhe 2009, iu kërkua sqarime subjektit. Së bashku me dokumentacionin provues, subjekti ka sqaruar se ky shtetas është djali i hallës së saj, dhe se ajo nëpërmjet prokurës së posaçme ka tërhequr pensionin e pleqërisë së hallës dhe bashkëshortit të saj dhe ua ka dërguar në Belgjikë, ku jetojnë prej shumë vitesh.
Komisioni e ka vlerësuar bindës shpjegimin e subjektit, të mbështetur në dokumentacion provues.
Komisioni ka hetuar edhe për llogaritë bankare të motrës së subjektit, si dhe kredinë bankare të marrë nga subjekti më datë 24.5.2017.
Gjatë këtij hetimi, nuk kanë rezultuar problematika të tilla që mund të lindin dyshime për fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë.

Konkluzioni përfundimtar mbi vlerësimin e pasurisë së subjektit

Pasi u hetua në mënyrë të thelluar mbi të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, Dhorina Theodhori, ka qenë e saktë në deklarimin e saj në deklaratën "Vetting".
Komisioni çmon se subjekti, ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të veta, si detyrimi kryesor kushtetues i tij.
Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Dhorina Theodhori, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimve dhe kushteve të parahikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017 për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.
Si konkluzion, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, znj. Dhorina Theodhori.

Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e kontrollit të figurës, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit, znj. Dhorina Theodhori, arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa "b", të ligjit nr. 84/2016, pasi nga verifikimet e kryera nuk rezultoi se ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ka dorëzuar në kohë deklaratën për figurën, si dhe nuk ka bërë deklarime të pasakta ose nuk ka fshehur kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Prokuroria e Përgjithshme;
- Kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë";
- Denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

Prokuroria e Përgjithshme ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar 3 dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 24.4.2018.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

1. Formularit të vetëdeklarimit, 3 (tre) dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
2. 5 (pesë) dosje penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
3. Të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë;
4. Në Prokurorinë e Përgjithshme - sektori i burimeve njerëzore dhe marrëdhënieve me publikun, Drejtoria e Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative, Zyra e Informacionit të Klasifikuar dhe Sektori i Protokoll-Arkivit.
5. Arkivi i 23 prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë.

Sipas të dhënave arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, gjatë periudhës së rivlerësimit, për subjektin e rivlerësimit nuk kanë rezultuar ankesa të asnjë natyre dhe as masa disiplinore, të përfunduara apo në fuqi.
Nga verifikimet në Zyrën e Informacionit të Klasifikuar, si dhe Drejtorinë e Përgjimeve të Telekomunikimit dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative, në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në 23 prokuroritë e shkallës së parë, nuk rezulton të ketë të dhëna që kanë të bëjnë me indicie apo të dhëna të ardhura nga agjensitë ligjzbatuese për fillim hetimesh, përfshirje drejtpërdrejt apo indirekt në veprime të dyshimta etj.

Në sektorin e protokoll arkivës në Prokurorinë e Përgjithshme, është gjetur një ankesë e shtetasit V. Z., ndaj subjektit të rivlerësimit. Ankesa është depozituar pranë zyrës së sektorit publik në Prokurorinë e Përgjithshme, me nr. ***, datë 15.1.2010, në vijim të praktikës së mëparshme, nr. *** prot., datë 20.5.2009.

Shtetasi V. Z. ka paraqitur ankesë në Prokurorinë e Përgjithshme, duke e drejtuar për dijeni edhe në disa drejtime të tjera, ku është pretenduar, lidhur me vrasjen e vëllait të tij, të quajtur F. Z., më datë 5.12.2008, në fshatin ***, ***, Korçë, se nuk janë kryer hetime të plota, si dhe për mungesë vullneti nga ana e prokurores për të bashkëpunuar me palën e dëmtuar.
Nga verifikimi i praktikës, konstatohet se, ankesa është shqyrtuar nga Prokuroria e Përgjithshme, e cila, me shkresën nr. ***, datë 2.2.2010, i ka kthyer përgjigje ankuesit në adresën e caktuar prej tij, duke e vënë në dijeni se letra është dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Korçë, për t'u vlerësuar nga kjo e fundit dhe për të konkluduar nëse ka vend për rifillimin e hetimeve.

Për këtë subjekt ka patur 6 denoncime, si më poshtë:

Në lidhje me tre denoncime, përkatësisht nga shtetasit **(1)** I. Z. **(2)** Xh. Q. dhe **(3)** V. Z., nga shqyrtimi i tyre, si dhe dosjes përkatëse, rezulton se nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njënashme apo korruptive nga ana e subjekti të rivlerësimit.

Ndërkohë nga ana e Komisionit janë hetuar në mënyrë të detajuar edhe ankimet e mëposhtme:

(4) Denoncim Anonim

Pranë Komisionit, si edhe pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, është administruar një informacion/denoncim anonim, nga i cili pretendohet se:

a) Subjekti i rivlerësimit ka pushuar çështjen në ngarkim të drejtorit të shoqërisë "Ujësjellës Kanalizime Korçë" sh.a, shtetasit P. T., në lidhje me abuzimin e tenderit 3.5 milion euro, me prokurim të drejtpërdrejtë;
b) Subjekti i rivlerësimit ka favorizuar personat e hetuar në rastin e veprave penale të kontrabandës;
c) Subjekti i rivlerësimit ka pushuar hetimit në ngarkim të shtetasit J. Gj., për shkak të lidhjeve shoqërore që subjekti i rivlerësimit ka me bashkëshorten e tij E. Gj.;
d) Subjekti i rivlerësimit, si drejtuese, në bashkëpunim me prokurorin O. E., ka kërkuar pushimin e një çështjeje penale ku pretendohej vjedhja e një sasie të madhe parash në linjën e autobuzave metro, për shkak të interesave dhe lidhjeve shoqërore midis subjektit të rivlerësimit dhe njërit prej përfaqësuesve të ortakëve të metrosë, shtetasit E. Ç.;
e) Subjekti i rivlerësimit ka një bashkëjetues për më shumë se 10 vjet; dhe i kërkohet Komisionit të verifikojë pasuritë e subjektit të rivlerësimit, vlerën e shtëpisë së bashkëjetuesit në qendër të Korçës dhe nëse kjo shtëpi është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

Në lidhje me këtë denoncim, nga ana e Komisionit i është dërguar shkresë nr. *** prot., datë 19.2.2018 Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë për të marrë dosjet përkatëse.
Më datë 1.3.2019, me shkresën nr. *** prot., kjo prokurori na ka vënë në dispozicion informacionin e kërkuar, nga analizimi i të cilit rezulton se:

a. Në ngarkim të shtetasit P. T. ka patur procedim penal nr. ***, i cili ka filluar bazuar në kallëzimin penal të Kontrollit të Lartë të Shtetit për veprën penale të shpërdorimit të detyrës.

Ky procedim rezulton të jetë hetuar nga subjekti i rivlerësimit, e cila ka vendosur pushimin e procedimit. Në vendimin e pushimit, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, argumenton se: "... *ka qenë Këshilli Bashkiak, i cili me vendimin nr. ***, datë 16.1.2013 "Për miratimin e marrëveshjes "Financim dhe instalim i sistemit elektronik për matësat e ujit" që do të lidhet midis "Ujësjellës Kanalizime Korçë" sh.a dhe shoqërisë "***" sh.p.k ka vendosur:*
Të miratojë marrëveshjen me objekt...

Ngarkohet administratori i shoqërisë të firmosë dhe realizojë të gjitha procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

*...Akti që ka përcaktuar dhe miratuar marrëveshjen është vendimi nr. ***, datë 16.1.2013 i Këshillit Bashkiak. Ka qenë ky i fundit që në pikën 2 të këtij vendimi ka ngarkuar me zbatimin e kësaj detyre administratorin e shoqërisë, i cili në rastin konkret nuk ka shprehur vullnetin që do të prodhonte pasojë juridike, por thjesht ka ekzekutuar vullnetin e Këshillit Bashkiak..."*

Nga studimi i dosjes, rezulton se është i vërtetë pretendimi i denoncuesit anonim në lidhje me pushimin e procedimit penal nr. ***, por nga analizimi i shkaqeve te pushimit nuk konstatohen elemente apo arsye për të konkluduar në shkelje ligjore apo dyshime për veprime korruptive.

b. Subjekti i rivlerësimit për periudhën 2016-2018 ka hetuar 4 çështje në lidhje me veprën penale të kontrabandës, nga të cilat një është pushuar, një pezulluar dhe dy janë dërguar për gjykim.

Pasi shqyrtoi të gjitha dosjet e ardhura nga Prokuroria, rezulton se pretendimi i denoncuesit anonim nuk qëndron.

c. Pas informacionit të plotë të ardhur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë, rezulton se në ngarkim të shtetasit J. Gj. ka patur gjithsej katër procedime, prej të cilëve vetëm njëri është ndjekur nga subjekti i rivlerësimit, ndërsa tre të tjerët janë ndjekur përkatësisht nga:

1. Procedimi penal, nr. ***, dërguar për gjykim hetuar nga prokurori E. S.;
2. Procedimi penal, nr. ***, hetuar nga prokurori O. E.;
3. Materiali kallëzues, për të cilin është vendosur mosfillim me nr. ***, hetuar nga prokurori G. S.;
4. Procedimi penal nr. ***, hetuar nga subjekti i rivlerësimit.

Nga studimi i dosjes nuk rezultojnë arsye për të konkluduar në shkelje ligjore apo dyshime për veprime korruptive.

d. Më datë 21.10.2016, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit Z. S., banues në Korçë, ka regjistruar procedimin penal nr. ***, për veprat penale "vjedhje me pasoja të rënda", parashikuar nga neni 134/3 i K. Penal dhe "mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe sendeve me vlerë", parashikuar nga nenin 179/a i K. Penal.

Procedimi penal ka nisur si pasojë e kallëzimit të shtetasit Z. S., i cili ka deklaruar se në muajin shtator të vitit 2015, i duhej një sasi e konsiderueshme të hollash për të luajtur në bursën e Stambollit. Nisur nga fakti që transferta me bankë kushtonte shumë, ai ka biseduar me shtetasin R. C., i cili punonte si shofer për shoqërinë "***", si dhe me shtetasin L. B., i cili është një nga pronarët e firmës. Me këtë të fundit, rrethanat e njohjes kanë patur të bëjnë me faktin se bashkëshortja e kallëzuesit e ka patur fqinj. Pasi kanë biseduar, të tre palët kanë rënë dakord që L. B. dhe R. C. do t'ia çonin të hollat në Stamboll kallëzuesit me mjetet e tyre të transportit... Më datë 18.9.2015 kallëzuesi shprehet se në banesën e tij ku ka qenë prezent edhe bashkëshortja me djalin i tyre N. S., i ka dhënë shtetasit R. C.., shumën 150.000 euro...

Në të njëjtën datë që kallëzuesi i ka dhënë shumën e eurove shtetasit R. C., ka nisur me autobusin ku punon R. C. dhe djalin e tij N. S. ...Rreth orës 12:45 djali i tij e ka marrë kallëzuesin në telefon dhe i ka thënë se ishte vjedhur autobusi, pikërisht në ***, kur kishin bërë një pushim 30 minuta.

Nga ana e prokurorisë janë kryer veprime hetimore ku përfshihen dhe letërporosi dërguar shtetit grek.

Pas kryerjes së veprimeve hetimore dhe mbërritjes së letërporosisë nga Greqia, nëpërmjet së cilës Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Aleksandropuli vë në dijeni se, pas kontrollit në arkivën elektronike, nuk u konstatua asnjë regjistrim kallëzimi për veprën penale të vjedhjes, nga asnjë prej personave të referuar në kërkesën e bërë, më datë 10.7.2018. Është vendosur pezullimi i hetimeve nga ana e prokurorit O. E., sepse autorët e veprës penale nuk njihen.

Kallëzuesi ka bërë ankim në Gjykatën e Rrethi Gjyqësor Korçë kundër vendimit të pezullimit të hetimeve, ankimi i cili është pranuar nga ana e kësaj gjykate me vendimin nr. *** datë 14.8.2018, duke vendosur rifillimin e hetimeve të procedimit penal dhe kryerjen e veprimeve hetimore më poshtë:

"*...Duhet të përcaktohet saktësisht nëse është pikërisht kjo prokurori, pra, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Aleksandropuli që ka juridiksion për nisjen e hetimeve për ngjarjen objekt hetimi, pasi në deklarimet e personave që kanë dijeni për veprën penale të pyetur nga prokuroria pretendohet se ngjarja ka ndodhur midis qytetit të Verias dhe Selanikut dhe gjithashtu pretendohet se është lajmëruar policia greke, e cila ka kryer veprimet hetimore për vjedhjen e kryer duke kryer dhe kontrollin fizik të gjithë pasagjerëve. Gjithashtu në përmbajtjen e vendimet të pezullimit pretendohet fakti se, ditën e nesërme të ngjarjes së bashku me shtetasin E.Sh kanë shkuar tek autogrill ku kishte ndodhur ngjarja dhe kanë parë filmimet e kamerave të sigurisë, ku ka rezultuar një person me kapele që është futur në autobus dhe më pas është larguar me një mjet që qëndronte në fund të parkimit.*

Në kuadër të një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm, në rast se nuk rezulton fillimi i ndonjë procedimi penal për këtë ngjarje nga autoritetet greke, pavarësisht kohës së gjatë që ka kaluar dhe mundësisë për të realizuar nga organi i prokurorisë duhet t'ju kërkohet autoriteteve greke të drejtësisë marrja e një sërë provash të vlefshme për hetimin si marrja e filmimeve nga kamerat e sigurisë, pyetja e personave që i kanë disponuar ato, si dhe të punonjësve të policisë që kanë qenë në vendngjarje. Në varësi të këtyre veprimeve hetimore, por edhe të veprimeve të tjera hetimore që do të çmohen të nevojshme të kryhen nga organi procedues, në raport dhe me të gjitha veprimet hetimore të mëparshme të kryera nga organi i prokurorisë, vetëm në rast se nuk njihen autorët e kësaj vepre penale mund të konkludohet në pezullimin e hetimeve..."

Pas rikthimit të procedimit nga gjykata, më datë 15.11.2018, subjekti i rivlerësimit ka pranuar kërkesën për përjashtimin e prokurorit O. E. nga ky procedim duke e zëvendësuar me prokurorin I. B. Çështja penale aktualisht është ende në fazën e hetimit.

e. Në lidhje me denoncimin se subjekti i rivlerësimit ka një bashkëjetues për më shumë se 10 vjet, dhe i kërkohet Komisionit të verifikoje pasuritë e subjektit të rivlerësimit, vlerën e shtëpisë së bashkëjetuesit në qendër të Korçës dhe nëse kjo shtëpi është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

Komisioni i ka kërkuar informacion subjektit të rivlerësimit nëse ajo bashkëjetonte prej 10 vjetësh me një shtetas, i cili punon si përmbarues. Në përgjigjen e saj ajo ka mohuar faktin e bashkëjetesës, duke deklaruar se ka jetuar dhe vazhdon të jetojë me nënën e saj, në adresën e deklaruar.

Duke qenë se denoncimi ishte anonim dhe nuk bënte të mundur marrjen e informacionit shtesë në lidhje me identitetin e bashkëjetuesit, Komisioni, për aq sa hetoi, nuk vërtetoi dot pretendimin e

denoncuesit në lidhje me bashkëjetuesin, duke qenë se nuk ishte dhënë një emër konkret, i cili mund të hetohej më tej nga ana e Komisionit.

Bazuar në të dhënat e administruara, konstatohet se nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratat e interesave private, por dhe në atë "Vetting", është deklaruar e njëjta adresë banimi, si dhe nga ana e saj, nuk është deklaruar asnjëherë që bashkëjeton me dikë, në kuptim të neneve 163[1] dhe 164[2] të Kodit të Familjes.

Gjithashtu nga verifikimi i regjistrit noterial nuk rezulton marrëveshje e lidhur para noterit, sipas nenit 164 të Kodit të Familjes.

Komisioni vlerëson se nga hetimi administrativ nuk provohet se subjekti i rivlerësimit bashkëjeton me dikë *de facto* apo *de jure* në kuptim të nenit 163 të Kodit të Familjes; në këto kushte, denoncimi anonim i administruar nga Komisioni në lidhje me verifikimin e shtëpisë së bashkëjetuesit nuk përbën provë, pasi nuk përmban të dhëna të tilla që mund të merren në konsideratë për vlerësimin e ndonjë shkeljeje ligjore, pasojat që ajo ka sjellë apo rrethana për fakte që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore në lidhje me kriteret e rivlerësimit.

Në këto kushte, kur nuk arrihet të provohet fakti i bashkëjetesës, kur denoncimi është anonim dhe nuk mund të kontaktohet për më shumë të dhëna, Komisioni vlerëson se nuk jemi përpara plotësimit të kushteve të përcaktuara në pikën 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, për termin "person tjetër i lidhur", në mënyrë që hetimet të shtrihen më tej për subjektin e rivlerësimit.

(5) Denoncim nga shtetasja A. Xh. F.

Pranë Komisionit është administruar denoncimi me nr. *** prot., datë 24.01.2019, që i përket shtetases A. Xh. F. Në lidhje me këtë denoncim, nga ana e Komisionit i është dërguar shkresë nr. *** prot., datë 19.2.2018 Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë, për të marrë dosjet përkatëse.
Më datë 1.3.2019, me shkresën nr. *** prot., Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë ka vënë në dispozicion informacionin e kërkuar nga ku rezulton se:

a) Në lidhje me shtetasin P. K. ka patur:
   1. Procedim penal, nr. *** dërguar për gjykim, i cili ka përfunduar dhe në Gjykatën e Apelit Korçë;
   2. Procedim penal, nr. *** në ngarkim dhe të znj. A. Xh. Kjo çështje penale mbi bazën e ankimit të prokurores Dhorina Theodhori është ende në fazën e gjykimit në Gjykatën e Apelit.

b) Në ngarkim të shtetasve P. K. dhe A. Xh., janë regjistruar kallëzimet e mëposhtme:
   1. Kallëzim, nr. ***, hetuar nga prokurori E. B., (mosfilluar);
   2. Kallëzim, nr. ***, hetuar nga prokurori O. V., (mosfilluar);
   3. Kallëzim, nr. ***, hetuar nga prokurori E. M., (mosfilluar);
   4. Kallëzim, nr. ***, hetuar nga prokurori Dhorina Theodhori, (mosfilluar);
   5. Kallëzim, nr. ***, hetuar nga prokurori D. N., (mosfilluar);

[1] Bashkëjetesa është një bashkim fakti midis burrit dhe gruas që jetojnë në çift, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët, që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie.
[2] Personat bashkëjetues mund të lidhin marrëveshje para noterit, ku përcaktojnë pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa lidhur me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës.

Ndërkohë janë regjistruar dhe procedimet penale:

1. Procedimi penal, nr. ***, hetuar nga prokurori E. Sh.;
2. Procedimi penal, nr. ***, hetuar nga prokurori I. B.;
3. Procedimi penal, nr. ***, hetuar nga prokurori E. Sh.;

Të gjitha këto hetime janë pushuar.

Duke vlerësuar këtë denoncim, Komisioni konstaton se më datë 8.1.2018, kërkuesja i është drejtuar në mënyrë të përsëritur zyrës së Prokurorisë, duke përmendur disa nga letrat që ajo ka dërguar; kontradiktat në përgjigjen e subjektit të rivlerësimit, si kreu i prokurorisë, për mosnjohjen e përmbajtjes së kallëzimit penal, të ndodhur në arkivat e prokurorisë së saj; për një konfirmim të çuditshëm të fakteve, që në thelb duken si një vendimmarrje e prokurorisë për mosfillimin e procedimit.

Neni 291 i Kodit të Procedurës Penale për "vendimi për mosfillimin e procedimit" përcakton se:
1. "*Kur ekzistojnë rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori lëshon një vendim të arsyetuar për mosfillimin e tij.*"

2. "***Vendimi u njoftohet menjëherë atyre (personave) që kanë bërë** kallëzim ose ankim, **të cilët mund të paraqesin një ankim në gjykatë, brenda 5 ditëve** nga njoftimi i vendimit.*"

Në rezultatet e hetimit, Komisioni i ka kërkuar shpjegime bindëse subjektit, pasi duket se komunikimi i prokurorisë nuk është në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për regjistrimin e kallëzimeve penale, procedurën që duhet të ndiqet në rast të mosfillimit të procedimit, dhe/apo njoftimet dërguar palës kërkuese në lidhje me procedurat e tjera të ngjashme/paralele në proces, në të njëjtën prokurori.

Në parashtrimet e saj, subjekti, pasi ka sqaruar me detaja rrethanat, ka deklaruar se: "*Në të gjitha shkresat, kjo shtetase është informuar se mund të paraqitet në çdo moment për të parashtruar çdo lloj kallëzimi penal. Për asnjë rast nuk ka ekzistuar asnjë motiv apo qëllim për të mos i kthyer përgjigje informuese dhe sqaruese kësaj shtetase,e cila ka marrë përgjigje të plotë dhe brenda afatit ligjor për çdo kërkesë të bërë nga ana e saj...*

*Njëkohësisht, në cilësinë e drejtuesit të institucionit dhe në përgjigje të kërkesave të kësaj shtetase, i është komunikuar edhe shkresa me nr. *** prot., datë 17.10.2017. Në këtë shkresë ne i kemi komunikuar faktin shtetases A. Xh., se, nga verifikimet e kryera, nuk rezulton që në ngarkim të shtetasve F. T. dhe Gj. N. të jetë regjistruar ndonjë procedim penal. Theksojmë faktin se në këtë shkresë unë e kam njoftuar këtë shtetase (në cilësinë e prokurores së çështjes penale nr. ***, të vitit 2015) se ekspertët për të cilat ajo ngre pretendime, kanë përpiluar një aktekspertimi, rezultatet e të cilit janë konfirmuar edhe nga ekspertët e caktuar si të tillë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, duke e informuar se është në detyrën e Prokurorisë (në rastin konkret në detyrën e prokurores së çështjes Dhorina Theodhori), që, nëse konstatonte elemente të veprës penale, të fillonte kryesisht hetimin penal në ngarkim të ekspertëve.*"

Pasi shqyrtoi deklarimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, si dhe e dëgjoi atë në seancë, Komisioni konstaton se subjekti i rivlerësimit i është drejtuar znj. A. Xh., jo vetëm në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, por edhe në cilësinë e prokurorit të çështjes, duke sqaruar se e ka informuar këtë shtetase se, nëse konstatohen elemente të veprës penale, do të fillonte hetimi

kryesisht. Në përgjigjen e saj, subjekti sqaron se, nuk jemi para një vendim mosfillimi, por një kthim përgjigjeje informuese.

Komisioni vlerëson se subjekti, në përgjigjen drejtuar kësaj shtetase, duhej të ishte pozicionuar dhe të kishte kthyer përgjigjen informuese, vetëm si drejtuese e prokurorisë. Duke qenë se ajo e ka kthyer këtë përgjigje, duke përfshirë edhe informacionin që kishte si prokurore e çështjes, ka krijuar konfuzion në qartësimin e kërkesës së bërë nga kjo shtetase. Komisioni çmon se komunikimi i saj me denoncuesen nuk është në formën e duhur, por nuk mund të konsiderohet i tillë, që të shërbejë si shkak për të konsideruar cenimin e etikës së prokurorit.

(6) Denoncim i shtetasit B. M.

Më datë 4.3.2019, ankuesi B. M. është ankuar pranë Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit për subjektin e rivlerësimit, duke pretenduar se, nga ana e saj nuk u tërhoq dosja nga gjykata civile, duke vendosur mosfillimin e hetimit. Nga dokumentet bashkëlidhur ankimit, rezulton se, z. B. M. së bashku me z. E. M., kanë bërë kallëzim penal më datë 19.2.2016, pranë Prokurorisë Korçë, për veprën penale të "falsifikimit të dokumenteve dhe shpërdorimit të detyrës". Më datë 7.3.2016, subjekti i rivlerësimit ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke argumentuar se:
"*Në bazë të nenit 272 të K.Pr.Civile ngelet në diskrecion të gjykatës që të vendosë sipas rastit, ose pezullimin e gjykimit deri në përfundim të procesit penal, ose të urdhërojë paraqitjen e provave me qëllim verifikimin e falsifikimit. Nga ana tjetër, prokuroria e Rrethit Gjyqësor do të vihej në lëvizje, pasi sekretaria e gjykatës do të dërgonte në prokurori dhe në organin shtetëror që ka nxjerrë shkresën, kopjen e vendimit që shpall shkresën si të falsifikuar. Në të njëjtin qëndrim është edhe udhëzimi nr. 288, datë 14.2.2001 i Prokurorit të Përgjithshëm, i cili orienton prokuroritë e rretheve gjyqësore që, në rast se ngrihen pretendime për falsifikim të dokumenteve në një proces civil, duhet që kallëzimet të priten nga sekretaria e gjykatës, sikurse e kërkon neni 275 i K.Pr.Civile. Baza ligjore për mosfillimin e hetimit është referuar në nenin 290/1/e.*"

Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit, në lidhje me referencën ligjore të përdorur për vendimin e mosfillimit, pasi dukej sikur kjo referencë nuk ishte e saktë.

Në lidhje me këtë rezultat të hetimit, subjekti sqaron se:
"*Sa i takon këtij materiali kallëzues, rezulton se me vendimin e datës 7.3.2016, unë, si prokurore, kam vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. 275 të vitit 2016 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Korçë. Saktësoj faktin se ky vendim mosfillimi është konfirmuar nga drejtuesi i Prokurorisë dhe njëkohësisht i është komunikuar kallëzuesit me shkresën me nr. *** prot., datë 17.3.2016. Pas verifikimit në arkivën e Prokurorisë, por edhe të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, rezulton se kallëzuesi nuk e ka ankimuar këtë vendim as tek organi epror, dhe as në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, pra, nuk ka kundërshtuar rezultatet e vendimit të mosfillimit të procedimit penal.*"
Vendimi i mosfillimit nuk cenon të drejtën e kallëzuesit për të ankimuar këtë vendim apo paraqitur një kallëzim të ri, pas përfundimit të procesit civil.

Subjekti ka arsyetuar, gjithashtu, se nuk ka gjetur asnjë indicie, sado të vogël, për të regjistruar këtë material kallëzues, si dhe pretendimeve të kallëzuesit i ishte dhënë një përgjigje nga një provë, e cila kishte fuqi të plotë ligjore dhe që ishte administruar në kuadër të procesit gjyqësor civil, i cili ishte duke u zhvilluar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë.

Për të disponuar drejt lidhur me pretendimet e kallëzuesit, duhet t'u referohemi edhe dispozitave të K.Pr.Civile, të cilat rregullojnë në mënyrë të posaçme problemin e falsitetit të një dokumenti të paraqitur në një proces gjyqësor civil.

Neni 272 i K.Pr.Civile parashikon se "*Kur krijohen dyshime serioze për falsifikim ndaj një personi konkret, edhe nëse shkresa që paraqitet si e falsifikuar, vlerësohet si thelbësore për sqarimin e çështjes, gjykata ka të drejtë të pezullojë gjykimin e saj deri në përfundimin e gjykimit të çështjes penale ose të urdhërojë të paraqiten prova për falsifikim.*"

Subjekti, në arsyetimin e saj, ka përdorur edhe udhëzimin nr. 288 prot., datë 14.2.2001 të Prokurorit të Përgjithshëm, i cili orienton prokuroritë e rretheve gjyqësore, që në rast se ngrihen pretendime për falsifikimin e dokumentave në një proces civil, duhet që kallëzimet të priten nga sekretaria e gjykatës, sikurse e kërkon neni 275 i K.Pr.Civile. Në këtë udhëzim, Prokurori i Përgjithshëm, sqaron se këto masa duhet të merren, pasi arsyet e këtyre kallëzimeve mund të jenë të ndryshme, sikurse mund të jenë edhe përpjekje për të pezulluar dhe shtyrë sa më shumë proceset civile, duke krijuar një ngarkesë artificiale në punën e organeve të prokurorisë, duke larguar vëmendjen dhe forcat nga proceset kryesore, që duhet të trajtohen me precedencë.

Në këto kushte, ka sqaruar subjekti, baza ligjore e përdorur në mosfillimin e këtij procedimi penal është neni 290/1, germa "e", pasi ekziston një referencë në ligjin procedural civil që normon rregullimin e situatave objekt kallëzimi, dhe njëkohësisht, edhe për shkak të mungesës totale të indicieve që duhet të orientonin prokurorinë në regjistrimin e këtij procedimi penal.

Subjekti, gjithashtu ka theksuar se ky protokoll i mosfillimit të procedimeve penale është ndjekur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor në raste të ngjashme, dhe se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka lënë në fuqi vendimet e mosfillimit me këtë arsyetim ligjor.

Në përfundim të hetimit, pasi shqyrtoi shpjegimet e subjektit, si dhe e dëgjoi atë në seancën dëgjimore, Komisioni vlerëson se vendimi i mosfillimit nuk cenon të drejtën e kallëzuesit për të ankimuar këtë vendim apo paraqitur një kallëzim të ri, pas përfundimit të procesit civil, për rrjedhojë nuk gjendemi përpara veprimeve që cenojnë figurën e prokurorit.

ANALIZA E GJETJEVE

Analiza e gjetjeve i referohet të dhënave të nxjerra nga tre grupet e burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) 5 dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short; dhe (iii) të dhënat nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme; (iv) denoncimet e publikut.

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se bën referim të saktë dhe të drejtë në normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në përgjithësi analizon normën penale të zbatueshme, në raport me faktet dhe provat, duke bërë referime dhe në ligje të tjera që kanë lidhje me çështjen konkrete.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet, kërkesat, dhe aktet e tjera të përpiluar prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Respekton përgjithësisht mirë rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të aktit procedural të prokurorit. Struktura e dokumenteve ligjore të saj u konstatua e qëndrueshme, e mirëorientuar dhe e standardizuar, bazuar në formularët standard në nivel prokurorie. Përgjithësisht, përmbajtja e akteve është gjithëpërfshirëse dhe analizon në tërësi rrethanat e faktit. Në tekstet e akteve ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur prokurori. Në nxjerrjen e konkluzioneve subjekti u ka kushtuar rëndësi analizës së normave ligjore.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e prokurorit në Njësinë e Përbashkët Hetimore, duke hetuar e përfaqësuar në gjykim kryesisht vepra penale të lidhura me korrupsionin dhe krimin ekonomik financiar. Për shkak të detyrës së drejtuesit të Njësisë së Përbashkët Hetimore, ka qenë njëkohësisht edhe zëvendësdrejtues i Prokurorisë Korçë dhe ka ushtruar kontrollin e dosjeve të përfunduara, jo vetëm nga prokurorët e Njësisë së Përbashkët Hetimore, por edhe të prokurorëve të tjerë të caktuar nga drejtuesit e Prokurorisë.

Në dosjet e vëzhguara evidentohet aftësi në organizimin e punës, respektim i afateve hetimore dhe përpjekje për të zgjidhur në mënyrë të drejtë çështjen. Edhe në rastet e procedimit penal ku janë zgjatur afatet hetimore, vendimi është i arsyetuar, duke përmendur shkaqet që e kanë diktuar atë, në mënyrë plotësisht të justifikuar. Nga aktet e analizuara, nuk u konstatuan vonesa apo zvarritje të qëllimshme në kryerjen e veprimeve hetimore apo në kalimin për veprim të tyre tek shërbimet e policisë gjyqësore, që ka çuar edhe në zgjidhjen e tyre sipas afateve kohore të përcaktuara në ligj.

Duke analizuar të dhënat e mësipërme, konstatohet se subjekti i rivlerësimit është efiçent dhe efektiv në drejtim të kohës së hetimit. Në efektivitetin dhe efiçencën e veprimtarisë së saj nuk ka ndikuar ngarkesa sasiore, e cila ka qenë relativisht e lartë. Në pjesën më të madhe të çështjeve të ndjekura prej saj, hetimet kanë përfunduar në afate të arsyeshme.

b) Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Subjekti i rivlerësimit Dhorina Theodhori kryen veprime procedurale hetimore dhe veprimet rezultojnë të jenë produktive. Konstatohet që nga ana e subjektit të rivlerësimit veprimet dhe procedurat në kuadër të procedimeve penale dhe materialeve kallëzuese, u referohen dispozitave ligjore përkatëse, duke mbledhur provat dhe aktet e nevojshme e duke arritur në vendimmarrje objektive. Përgjithësisht, veprimet procedurale janë dokumentuar mirë.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve hetimore të përzgjedhura me short, nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Nuk paraqiten mungesa në përmbajtjen formale të akteve, si data, nënshkrimi i pjesëmarrësve në të. Në fashikuj përfshihen të gjithë aktet që i përkasin çdo çështjeje konkrete.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Në vlerësimin e respektimit të disiplinës në punë, nga ana e prokurorit është përmbushur me besnikëri disiplina dhe të gjitha angazhimet profesionale, personale, morale dhe etike në ushtrimin e funksioneve të tij, në zbatim të Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, duke ruajtur të pastër figurën e prokurorit. Nga hetimi i kryer për kriterin e pasurisë, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk ka vepruar në mënyrë profesionale, duke përdorur burimet njerëzore të institucionit për qëllime personale.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Prokurori Dhorina Theodhori, gjatë periudhës së rivlerësimit nuk ka pasur masa disiplinore.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Dhorina Theodhori. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara, nuk ka të dhëna që të jetë kërkuar përjashtimi i tij nga hetimi i çështjeve apo nga përfaqësimi në gjykim i tyre. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Duke marrë parasysh të dhënat arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme si edhe 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Dhorina Theodhori të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet e vëzhguara, nuk ka të dhëna të plota për mënyrën e komunikimit të subjektit Dhorina Theodhori me palët e tjera në proces dhe me gjykatën. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Ka cilësi të mira bashkëpunuese, si dhe është e gatshme të punojë në grup dhe me agjenci të tjera ligjzbatuese. Është e hapur për diskutim dhe ndarje të përvojës me kolegët.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit ka marrë titullin "Jurist" në Universitetin e Tiranës, ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, profili "prokuror". Ajo ka deklaruar specializim në të drejtën penale, faktin se gjatë tre viteve të fundit është angazhuar në punën e saj si prokurore në hetimin e rasteve të korrupsionit dhe krimit ekonomiko-financiar.
Subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, por nuk ka paraqitur dokumente që vërtetojnë pjesëmarrjen në këto aktivitete, pasi siç deklaron vetë, nuk i ka tërhequr fizikisht nga shkolla. Gjithashtu, në periudhën e rivlerësimit, subjekti deklaron se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh jashtë Shkollës së Magjistraturës, kryesisht në lidhje me veprat penale të korrupsionit, krimit ekonomiko-financiar, pastrimit të parave dhe veprave penale kompjuterike, duke shprehur gatishmërinë e saj për t'u rritur nga ana profesionale.

Në përfundim të kësaj analize, në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit Dhorina Theodhori, konstatohet se ky subjekt ka treguar cilësi shumë të mira në punë, arsyetim dhe gjykim të drejtë, identifikon dhe analizon drejt problemet. Ajo njeh shumë mirë parimet e së drejtës, si dhe respekton në arsyetim të drejtat e palëve; është efiçente dhe efektive.

D. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara prej tij, konstaton se subjekti ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa "a", si dhe të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë",

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Dhorina Theodhori.

2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 19.4.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

PAMELA QIRKO
Kryesuese

ETLEDA ÇIFTJA
Anëtare

GENTA TAFA (BUNGO)
Relatore

Sekretare gjyqësore
FIORELA MANDRO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT